
RAPORT I AUDITUESIT TE PAVARUR

Auditimi i Pasqyrave Financiare per vitin 2023

30 QERSHOR 2024
ZUNA SH.P.K
Eksperte Ligjore Flutura Luke

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për Ortakun e Shoqërisë “Zuna” sh.p.k

Drejtimit te shoqerise

Opinion

Une kam audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë **“Zuna”sh.p.k**, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 31 Dhjetor 2022, pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tim me rezerve, pasqyrat financiare bashkëlidhur japin pamjen e vërtetë dhe të drejtë për, pozicionin financiar të Shoqërisë me datën 31 Dhjetor 2023, dhe performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK).

Baza për Opinionin

Pasqyrat financiare te shoqerise Zuna te dates 31.12.2023 ne zerin inventare paraqiten per shumen 122.374.649 leke dhe per vitin 2022 paraqiten per Shumen 107.440.810 leke.Pune ime si audituese filloi ne Qershor 2024 ,per rrjedhoje une nuk kam marre pjese dhe vezhguar numerimin fizik te inventarit te mallrave te dates 31.12.2023.Nuk munda te marr siguri nepermjet procedurave alternative ne lidhje me sasine dhe vlerat e mbartura te inventarit ne 31 dhjetor 2023.Rrjedhimisht nuk jam ne gjendje te percaktoj nese ndonje rregullim ishte i nevojshem per vlerat e inventarit te dates 31.12.2023

Une e krevia auditimin tim në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në shoqerine **“Zuna”sh.p.k** dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa.Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.



Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SKK, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat e mia janë që të arrijmë një siguri të arësyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arësyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritët që në mënyrë të arësyeshme, të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit.

Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontroleve të brendshme.



- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin, me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinioni mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Ne gjithashtu, ju japim personave të ngarkuar me qeverisjen një deklaratë që ne jemi në pajtim me kërkesat përkatëse etike në lidhje me pavarësinë, dhe ju komunikojmë atyre të gjitha lidhjet dhe çështjet e tjera që mundet në mënyrë të arsyeshme, të ndikojnë në pavarësinë tonë, dhe kur është e zbatueshme, masat mbrojtëse përkatëse.

Nga çështjet e komunikuar personave të ngarkuar me qeverisjen, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishmet për auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale dhe për pasojë edhe çështje kryesore të auditimit. Ne i përshkruajmë këto çështje në raportin tonë të auditimit përveç nëse në rastin kur ligji ose rregullat e ndalojnë bërjen publike të çështjes ose kur, në rast jashtëzakonisht të rralla, ne vendosim që çështja të mos komunikohet në raportin tonë për arsye se pasojat negative nga një komunikim i tillë pritet në mënyrë të arsyeshme të tejkalojnë përfitimet në favor të interesit publik.

Auditues Ligjore

Flutura Luke

Flutura Luke



30.06.2024

Pergatitur nga Flutura Luke, Eksperte Kontabel e Rregjistruar Raport auditimi "Zuna" sh.p.k.NIPTI
K36309769F ,Diber

Zuna Sh.p.k
Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2023
Shenime per pasqyrat Financiare 2023

PËRMBAJTJA:

FAQE

PASQYRAT FINANCIARE:

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	3
PASQYRA E PERFORMANCËS	4
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	5
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	6
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	7-19

**Pasqyra e Pozicionit Financiar
më 31 dhjetor 2023**

	Shënime	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
AKTIVE			
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	4	3.769.688	13.942.057
Llogari të arkëtueshme tregtare	5	8.533.524	14.566.522
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	6	0	0
Të tjera llogari të arkëtueshmetvsh,t,fitimi	7	1.985.832	4.133.307
Inventarë	8	122.374.649	107.440.810
Parapagime dhe shpenzime të shtyra	9	41.835.500	41.835.500
Totali i aktiveve afatshkurtra		178.499.193	181.918.196
Aktivet afatgjata			
Aktive afatgjata materiale	10	109.986.016	110.295.749
Totali i aktiveve afatshkurtra		0	0
Totali i aktiveve		288.485.209	292.213.945
DETYRIMET			
Detyrime afatshkurtra			
Titujt e huamarrjes	11	0	0
Hua afatshkurtra	12	69.598.036	69.028.087
Llogari të pagueshme tregtare	13	40.758.960	37.692.398
Detyrime ndaj punonjesve per pagat	14	20.095.465	19.014.768
Detyrime tatimore	15	290.620	250.263
Parapagimet e arketuara	16	0	0
Të ardhurat e shtyra	17	-	-
Të tjera detyrimendaj ortakeve	18		
Totali i detyrimeve afatshkurtra		130.743.081	125.985.516
Detyrime afatgjata			
Detyrime afatgjata hua	19	63.093.224	78.466.482
Grande	20	18.633.621	18.633.621
Totali i detyrimeve afatgjata		81.726.845	97.100.103
Totali i detyrimeve		212.469.926	223.085.619
Kapitali			
Kapitali i nënshkruar		8.302.000	8.302.000
Rezerva ligjore		3.138.987	3.138.987
Rezerva të tjera		0	0
Fitimi I pashperndare		57.687.339	51.641.314
Fitimi i ushtrimit		6.886.957	6.046.025
Totali i kapitalit	21	76.015.283	69.128.326
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		288.485.209	292.213.945

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 19, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

6

Pasqyra e Performancës
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	22	255.859.704	290.430.241
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	23	492.436	3.149.834
Totali te ardhura		256.351.140	293.580.075
Lënda e parë, materiale të konsumueshme dhe të tjera shpenzime (KMSH)		-215.010.372	-256.602.788
1) Lënda e parë, materiale të konsumueshme	24	-215.010.372	-256.602.788
2) Të tjera shpenzime	25	0	0
Shpenzime të personelit	26	-12.665.804	-13.330.773
1) Paga dhe shpërblime		-9.378.848	-11.423.113
2) Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetësore		-3.286.956	-1.907.660
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	27	-6.385.036	-4.836.506
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	28		-10.416.316
Shpenzime financiare	29	-843.573	-1.252.656
1) Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme		-843.573	-1.252.656
2) Shpenzime të tjera financiare		0	
Totali shpenzimet e aktivitetit		-248.248.838	-286.439.039
Fitimi/humbja para tatimit		8.102.302	7.141.036
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	30	1.215.345	1.095.011
1) Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin		1.215.345	1.095.011
2) Shpenzimi aktual i tatimit të shtyrë			-
Fitimi/humbja e vitit		6.886.957	6.046.025
Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin			-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin		6.886.957	6.046.025

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 19, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.



Zuna sh.p.k NIPTI K36309769F, Diber Peshkopi Lagjja "TREG", Rruga "Ismail FETA" ndërtesa private 40 m larg nga Ura e Qytetit Peshkopi, Diber

Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023
Zuna sh.p.k

	Kapitali i nënshkruar	Rezerva Ligjore	Rezerva të tjera	Dividendë për t'u paguar	Fitim / Humbja e vitit	Totali
Pozicioni më 1 janar 2022	8,302,000	2.802.437	45.246.856	-	6.731.008	63.082.301
Të ardhura totale gjithpërfshirëse për vitin:						
Fitimi / Humbja e vitit	-	336.550	6.394.458	-	(6.731.008)	-
Transferim i fitimit	-	-	-	-	-	-
Dividendë të paguar	-	-	-	-	6.046.025	6.046.025
Pozicioni më 31 dhjetor 2022	8,302,000	3.138.987	51.641.314	-	6.046.025	69.128.326
Totali i të ardhura gjithpërfshirëse për vitin:						
Fitimi / Humbja e vitit	-				6,886,957	6.886.957
Transferim i fitimit	-		6.046.025		-6.046.025	0
Dividendë të paguar	-					
Emetim kapitali	-	-	-	-	-	-
Pozicioni më 31 dhjetor 2023	8.302.000	3.138.987	57.687.339		6.886.957	76.015.283

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 19, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023 janë aprovuar nga administratori i Hodo Alb shpk dhe janë firmosur si më poshtë.

Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023

	Shëni me	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022
Flukset e parasë nga aktivitetet operative			
Fitim / Humbja e vitit		6.886.957	7.141.036
<i>Rregullimet për shpenzimet jomonetare:</i>			
Shpenzimet financiare jomonetare			12.639.856
Shpenzime konsumi dhe amortizimi		6.385.037	4.836.506
Vlera kontabël neto e aktiveve të shitura		-	-
<i>Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit:</i>			
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera		8.180.473	3.193.035
Rënie/(rritje) në inventarë		-14.933.839	-(6.867.433)
Rënie/(rritje) në parapagime dhe shpenzime të shtyra		0	-(41.835.500)
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme		4.757.565	(19.508.354)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit		11.276.193	46.786.924
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit			
Pagesa për blerjen dhe shitjen e aktiveve afatgjata materiale		-6.075.304	-26.292.863
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		-6.75.304	-26.292.863
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit			
Arkëtime nga emetimi i kapitalit aksionar		0	0
Hua të arkëtuara (të paguara dhe të arkëtuara)		-15.373.258	78.466.482
Dividendë të paguar		0	0
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		-15.373.258	
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit			
Ndryshimi neto i mjeteve monetare		-10.172.369	5.386.695
Mjetet monetare në fillim të periudhës		13.942.057	8.555.362
Mjetet monetare në fund të periudhës	4	3.769.688	13.942.057

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 19, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. Informacion i përgjithshëm

“Zuna” sh. p. k. është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar regjistruar në QKB në datën 06.07.2007 mbështetur në ligjin nr 7638 dt 19.11.1998 , e ndryshuar(ligjin 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare) si dhe në ligjin 7512 dt 10.08.1991 “ Per Regjistrin Tregëtar regjistruar ,me Nipt L01308050F

Selia e shoqërisë është në Kamez, Tiranë.

Kapitali i shoqërisë përbëhet nga 1(një) kuote për një vlerë totale 8.302.000(tetë milion e treqind e dy mijë) LEKE

Ortaku i shoqërisë është **z.Bardhyl Zuna**, shtetas Shqiptar, i cili zotëron të gjithë kapitalin e shoqërisë të depozituar në QKB

Administrator i shoqërisë është **z.Bardhyl Zuna**

Aktiviteti kryesor i kësaj shoqërie është Tregëtim me shumicë dhe pakicë, import eksport të mallrave të ndryshëm. Agjent i Shoqërisë EasyPay Sh.p.k.(Institucion i parasë elektronike) për kryerjen e shërbimeve që përfshijnë por që nuk kufizohen në pagesa faturash & shitje të mallrave/shërbimeve të partnerëve të EasyPay, rimbushje elektronike etj.Hapje bar kafe dhe kënd lojrash për fëmijë.Punime të ndërtimit.

Per v.2023 ka pasur 29 punonjës sipas pasqyrës së mëposhtme:

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.9228, datë 29 prill 2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumë të raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve të detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)

2.5. Vlerësime dhe gjykime (vazhdim)

2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50%, në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2023 dhe 2022 është detajuar si më poshtë:

	2023	2022
euro	103.88	114.23
USD/ LEK	93.94	107.05

3.2. Instrumentat financiarë

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivitetet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2 Instrumentat financiarë (vazhdim)

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën dhe llogaritë rrjedhëse.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Kapitali themeltar

Kapitali njihet me vlerën nominale.

3.3 Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitetit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitetit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitetit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitetit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes.

Normat e amortizimit për efekt fiskal për vitin aktual janë si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Norma e Amortizimit
Mobilje për zyrën	20 %
Mjete transporti	20 %
Makineri dhe paisje	20 %
Pajisje për zyrën dhe informatike	25 %

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.3 Aktive afatgjata materiale (vazhdim)

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëhere kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.4. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

3.5. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

3.6. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.7. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.8. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.9. Tatimi mbi fitimin



Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2019 është 15%, (2018: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Shoqëria nuk ka burime diferencash të përkohshme që vijnë nga tatimi i shtyrë mbi fitimin.

3.10. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributesh pensioni të përcaktuar.

3.11. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.12. Aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

04. Mjete monetare

Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022:

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Mjete monetare në bankë leke	2.195.750	4,601,769
Mjete monetare në bankë euro		
Mjete monetare në arkë leke	1.573.938	9,340,288
Mjete monetare në arkë euro		0
	3.769.688	13,942,057

05. Llogari të arkëtueshme tregtare

Llogaritë e arkëtueshme tregtare, detyrimet e klienteve më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022 paraqit si më poshtë:

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Klientë	8.533.524	14,566,522
	8.533.524	14,566,522

06. Llogari te arkëtueshme per palet e lidhura

Detyrimet e arkëtueshme per palet e lidhura më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022 paraqitet si më poshtë:

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Detyrime te ortakut	-	-
	-	-

07. të tjera llogari të arkëtueshme

Llogaritë të tjera të arkëtueshme më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Shteti- TVSh për tu rimbursuar	1.807.887	4,002,366
Tatim mbi fitimin	177.945	130,941
Të arkëtueshme nga dogana		-
Të tjera kërkesa nga të tretë		-
	1.985.832	4,133,307

08. Inventari

Inventari më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022 paraqitet si më poshtë:

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Materiale të para	0	0
Materiale të tjera	0	0
Mallra	122.374.649	107,440,810
Inventar i imët	0	0
	122.374.649	107,440,810

09.Shpezmet e periudhave te ardheshme

Shpenzimet e parapaguara per daten 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022 paraqiten:

Jane shpenzimet per lejet e ndertimit.

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Shpenzimet per lejet e ndertimit	41.835.000	41,835,500
	41.835.000	41.835.000

10. Aktivitet Afatgjata Materiale

Gjendja dhe levizja e Asteve per v.2023

	Ndertesa	Makineri dhe paisje	Mjete transporti	Inventar Ekonomik	Pajisje infor matik e	Totali
Zuna 2023						
Asetet						
Gjendja me 01.01.2022	112.041.106	2.345.351	1.827.490	1.257.999	370.624	117.842.570
shtesat	2.506.293	3.221.262	0	24.967	347.749	6.075.304
pakesimet	-	-	-	-	-	-
Gjendja me 31.12.2022	114,547,399	5,566,613	1,827,490	1,257,999	718,373	123,917,874
Amortizimi						
Gjendja me 01.01.2023	6,657,083	131,769	640,346	24,967	92,656	7.546.821-
shtesat	5.324.094	503.348	237.429	246.606	73.559	6.385.037
pakesimet	0	0	0	0	0	0
Gjendja me 31.12.2023	11,981,177	635,117	877,775	271,573	166,215	13,931,858
VI e mbetur 31.12.2022	105,384,023	2,213,582	1,187,144	1,233,032	277,968	110,295,749
VI e mbetur 31.12.2023	102,566,222	4,931,496	949,715	986,426	552,158	109,986,016

6

11. Hua Afatshkurter

Huaja afatshkurtër më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022 paraqitet si më poshtë:

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Hua afatshkurtra	69,598.036	69,028,087
Kredi bankare	-	-
totali	69,598.036	69,028,087

12. Llogari të pagueshme tregtare

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2022
Llogari të pagueshme tregtare	40.758.960	37,692,398
	40.758.960	37,692,398

13. Detyrime per Paga te Pagueshme

Detyrimet per pagat e papaguara ndaj punonjesve më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022 paraqiten si me poshte:

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Detyrimet per pagat e papaguara	20.095.465	19,014,768
	20.095.465	19,014,768

14. Detyrimet Tatimore

Detyrimet tatimore per Sigurime shoqerore, TVSH dhe tatim ne burim më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022 si me poshte:

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
T.V.SH	-	-
Ddetyrime per sigurimet shoqerore	287.370	250,263
Detyrime per TAP	3.250	
	290.620	250,263

15. Detyrimet Afatgjate Hua

Detyrimet afatgjate më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022 paraqiten si me poshte:

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2023
Kredia afatgjate	63.093.224	78,466,482
	63.093.224	78,466,482

16. Detyrimet te tjera Afatgjate

Detyrimet e tjera afatgjate më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022 paraqiten si me poshte:

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Grande	18.633.621	18,633,621
	18.633.621	18,633,621



17.Kapitali

Kapitali themeltar per daten 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022 paraqitet:

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Numri i kuotave	1	1
Vlera nominale (në LEK)		
Kapitali i nënshkruar	8,302,000	8,302,000

Kapitalet e veta te Shoqërisë per daten e mbyllur ne 31 Dhjetor 2023 dhe 31 Dhjetor 2022 jane :

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Kapitali aksionar	8,302,000	8,302,000
Rezerva ligjore	3,138,987	3,138,987
Fitimet e pashperndara	57.687.339	51,641,314
Fitimi/Humbja e vitit financiar	6.886.957	6,046,025
	76.015.283	69,128,326

18.Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022:

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Të ardhura nga shitja e mallrave	255.859.704	290,430,241
te ardhura te tjera	491.436	2,830,088
Te ardhura te tjera nga AKPA	0	319,746
	256.351.140	293,580,075

19.Kosto e mallrave te shitur

Kosto e mallrave te shitur ne daten 31 dhjetor 2023 dhe ne daten 31 dhjetor 2022 paraqitet

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Kosto e mallrave te shitur	215.010.372	256,602,788
Totali	215.010.372	256,602,788

20.Shpenzime të personelit

Shpenzimet e personelit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022:

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Shpenzime për paga	9.378.848	11,423,113
Shpenzime për sigurime shoqërore e shëndetësore	3.286.959	1,907,660
	12.665.804	13,330,773

21.Shpenzime konsumi dhe amortizimi

Shpenzimet e konsumit dhe amortizimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022:



	31dhjetor2023	31 dhjetor 2022
Shpenzime amortizimi	6.385.036	4,836,506
	6.085.036	4,836,506

22. Të tjera shpenzime

Shpenzimet e tjera detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022:

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Blerje materiale	58,733	211,782
Blerje materiale e te tjera	126,116	-
Blerje naftë & gaz	2,609,643	4,568,837
Mirëmbajtje dhe riparime	866,467	-
Të tjera	283,984	1,070,051
shpenzime GO TECH FEE kontrate	1,721,752	383,320
Sherbime		
siguracioni	240,005	-
Shpezime		
kontabiliteti	210,000	-
Shpenzime per interesa	92,832	-
Reklame publicitet	104,846	-
Shpenzime telefonike energji	6,224,196	2,797,772
Shpenzime për shërbimet bankare	194,779	409,218
Taksa dhe tarifa vendore	610,700	816,300
Gjoha dhe dëmshpërblime		159,036
totali shpenzime te tjera te bilancit	13,344,053	10,416,316

23. Shpenzime financiare

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit dhe rezultatin nga kursi i këmbimit që lidhet me aktivitetin financiar të shoqërise. Ky zë detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022:

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Të ardhura nga interesat	-	0
Shpenzime për interesa	843.573	1,252,656
Fitim / (Humbje) nga këmbimet valutore (neto)	-	-
	843.573	1,252,656

24. Shpenzimet per tatim fitimi dhe shpenzimet e panjohura

Përlllogaritja e shpenzimit për tatimin mbi fitimin paraqitet më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023

	8.102.302	7,141,036
fitim humbje para takses		
Gjoha dhe dëmshpërblime	0	159,036
Humbje nga gabime te lejuara ne ushtrimet	0	-
Fitimi tatimor	8.102.302	7,300,072
tatimi I fitimit	1.215.345	1,095,011
fitim humbje neto e bilancit	6.886.957	6,046,025

25. Ngjarje pas bilancit

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.

Date 30 Qershor 2024.

